



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 108 prot.

Kamëz, më 01.08.2023

**V E N D I M**  
**Nr 76 Datë 01/08/2023**  
**PËR NJE NDRYSHIM NE V.K.B NR.166 DATE 21.12.2022 PER**  
**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE TE PUNONJESVE TE CERDHEVE TE**  
**BASHKISE KAMEZ PER VITIN 2023.**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.01/08/2023, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.47 dt 27/07/2023,

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b", nenit 54, shkronja "ç", nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenit 6, shkronja "c" dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", në VKM –në nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike" vendimit nr. 113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi",

**V E N D O S I**

1. Miratimin e nivelit të pagave për punonjëset e cerdheve sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Efektet financiare do të fillojnë nga data 01.04.2023.
3. Pagat e punonjësve administrative, të jenë në masën 47,000 (dyzete e shtate mije ) lekë në muaj sipas pikës 11, të VKM-së të sipercituar.

Niveli i pagave për punonjësit e Çerdheve Bashkia Kamez

Pozicioni	Kategoria	Grupi	Shtesa vjetërsi per	Shtesa per pozicion	Arsimi
Pergjegjes cerdhe	IV-A	1/2/3	2%	56,000	I Larte
Edukatore cerdhe	IV-B	1/2/3	1% ose 2%	44,000	I Larte/i mesem
Psikologe	IV-B	1/2/3	2%	44,000	I Larte
Infermiere	IV-B	1/2/3	1% ose 2%	44,000	I Larte/i mesem

Grupi Diplomes	Lloji i Diplomes	Vlera
1	Master i shkencave, master i arteve Te barasvlershme me to sipas legjislacionit te arsimit te larte	14000
2	Master profesional Te barasvlershme me to sipas legjislacionit te arsimit te larte	12000
3	Bachelor Te barasvlershme me to sipas legjislacionit te arsimit te larte	10000

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYETAR  
HYSEN KOLDASHI